



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-336

17.10.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, nenin 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.172/14), pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3350/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3741/3 datë 17.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 33-të mbajtur më 16.10.2023, miratoi si vijon:

#### **Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, për shkeljen e kryer të nenit 50, paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, më 10 gusht 2023, janë transmetuar mjaft programe artistike pa u shënuar me sinjalistikën përkatëse për mbrojtjen e të miturve para fillimit dhe gjatë transmetimit të tyre.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3350/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1

2. URDHËROHET SHTR G -TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

#### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimit mediatik audiovizual sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, vërtetimeve të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – vërejtje publike në pajtimin me këtë Ligjin, në rastet kur është kryer cënimi ose

shkelje e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50, paragrafi (1) nga LSHMAAV, radiodifuzerët nuk duhet të transmetojnë ose të bartin programe që mund seriozisht të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të personave të mitur, veçanërisht programe me përmbajtje pornografike ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve, sipas kërkesës, duhet të ndër marrin masa të rrepta teknike për të siguruar që personat e mitur të jenë të mbrojtur nga përmbajtjet e dëmshme siç janë dhuna e tepruar dhe pornografia. Përveç programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të personave të mitur, sigurohen edhe nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale kështu që personat e mitur duhet të mos munden në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i shohin ose t'i dëgjojnë programet. Nëse programet transmetohen ose ritransmetohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual, obligohet para transmetimit të programit të siguron paraprakisht sinjalizim akustik dhe mundësi identifikimi me ndihmën e shenjave vizuale për të gjithë transmetimin e programit (neni 50, paragrafi (3) nga LSHMAAV).

Në nenin 19 të RRMPM është përcaktuar se sinjalizimi paralajmërues detyrimisht aplikohet para fillimit dhe gjatë kohës së transmetimeve të programeve të shërbimeve programore televizive dhe në vendin përkatës të programeve në dispozicion kemi katalogun e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, dhe atë: në të gjitha llojet e programeve artistike, dhe në ato lloje të programeve me funksion informativ, arsimor ose argëtues, i cili në tërësi ose pjesërisht, mund të ndikojnë negativisht mbi personat e mitur.

Në kuadër të kompetencave Ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 1 shtator 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR G -TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 10 gusht 2023, në nivel lokal, nga ku u konstatua shkelja e nenit 50, paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 19 të RRMPM.

Gjegjësisht, me mbikëqyrjen e rregullt programore është konstatuar se në kundërshtim të nenit 19 (aplikim i sinjalizimit paralajmërues) i RRMPM, të shërbimit programor televiziv të SHTR G -TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 10 gusht 2023, pa sinjalizimin paralajmërues për mbrojtjen e personave të mitur para fillimit dhe gjatë kohës së transmetimit janë transmetuar disa programe artistike, dhe atë: „Kapiten Amerika - lufta civile“ (Captain America - civil war) – film kinematografik; „Batman v Superman“ (Betmen kundër Supermenit) – film kinematografik; „Storks“ (Штркови) – film i animuar; „Just For Laughs Gags“ – shfaqje humoristike TV/ kamera e fshehtë dhe „La Véritable histoire du petit chaperon rouge “ (Përadha e vërtetë e Kësulkuqes) – film i animuar, si dhe pa sinjalizimin paralajmërues para fillimit të transmetimit është transmetuar dhe „Film artistik“.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3350/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e tëtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR G -TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, me datë 06.09.2023, dërgoi Shkresë me nr.y në ark.10-3350/2 datë 06.09.2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3350/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV dhe RRMPM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e radiodifuzerit më 12.09.2023. Në afatin e parashikuar, SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, nuk dorëzoi deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV dhe RRMPM. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 16.10.2023, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim erdhi në përfundim SHTR G -TV TELEVISIONI SHPKNJP Gostivar t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenin 19 nga RRMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvenimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3350/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3741/3 datë 17.10.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave nga LSHMAAV dhe nga RRMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 6.10.2023, miratoi Aktvendimin me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR G -TV TELEVISIONI SHPKNJP Gostivar, dhe obligohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe RRMPM. Pas mbarimit të afatit

përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3350/1 datë 01.09.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.